



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Me shkresën nr. 302/7 datë 18.07.2023 “Njoftim përqendrimi përfundimtar dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar mbi nënshkrimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Referuar “Marrëveshjeve për Blerjen e Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

**Pala blerëse: Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.**, është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kilit, e angazhuar në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë hidroelektrike.

Blerësi zotërohet nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, pjesë e grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

**Shoqëritë Target : Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA** janë shoqëri të themeluara sipas legjislacionit të Kilit, të angazhuara në zhvillimin e projekteve të energjisë përkatësisht nga era. Qëllimi i shoqërive është të prodhojnë, transportojnë, shpërndajnë, furnizojnë, blejnë dhe shesin energji elektrike, etj.

Shoqëritë Target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

**Pala shitëse: Inversiones Bosquemar SpA** është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Kilit, e angazhuar në prodhimin e energjisë përkatësisht nga era.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**